



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.195 dt.15.12.1997

PER
CELJEN E FONDEVE PER BLERJEN E MATERIALEVE DHE
KRYERJEN E PUNIMEVE PER NEVOJAT E BASHKISE PER VITIN
1998.

Këshilli i Bashkisë Tiranë, i mbledhur sot me dt.15.12.1997, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendëshme, mbështetur në ligjin Nr.7776, dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal” ligji Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” në Republikën e Shqipërisë

VENDOSI

1. Të miratojë shumën prej 100.000(njëqindmijë)lekë për blerjen e aparateve telefonike për Njësitë Administrative.
2. Të miratojë shumën 60.000(gjashtëdhjetmijë)lekë për blerjen e reflektorëve për ngrohje.
3. Të miratojë shumën 40.000(dyzetmijë)lekë për blerjen e makinave llogaritëse.
4. Të miratojë shumën 200.000(dyqindmijë)lekë për vendosjen e një kuadri të ri elektrik për godinën e Bashkisë.
5. Të miratojë shumën 70.000(shtatëdhjetmijë)lekë për blerjen e printerit të centralit telefonik.
6. Të miratojë shumën prej 60.000(gjashtëdhjetmijë)lekë për blerjen e një sasive tavolinash dhe karrigesh për nevojat e zyrave të Bashkisë.
7. Të miratojë shumën prej 200.000(dyqindmijë)lekë për heqjen dhe vendosjen e pllakave të reja në korridorin e katit të parë të Bashkisë.
8. Të miratojë shumën prej 1.500.000 (njëmilionepesëqindmijë)lekë për çdoganimin e kaldajës së re të Bashkisë. Dhuratë nga Bashkia e Mantovës në Itali.
9. Të miratojë shumën prej 7.350.000(shtatëmilionetrqindpesëdhjetmijë (shtatëmilionetrqindpesëdhjetmijë)lekë për blerjen e karburantit për një periudhë njëvjeçare.
10. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Brendëshme.
12. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI